

Fjalë të Mëdha – Pjesa 7

Përsëritje miq! Gëzohem shumë që ju shoh. Mirë se keni ardhur. Uroj të keni ardhur me pritje për të marrë diçka nga mesazhi sot.

Sot mbyllim serinë "Fjalë të Mëdha".

Fjalët e mesazhit sot janë: **Plot Shpresë**.

Cila është një nga gjërat më të rëndësishme për një lider? Të jesh i inkurajuar. Të jesh plot shpresë, të jesh plot inkurajim; këtë do të ndaj sot.

Ndoshta ti thua, "Por unë s'jam lider." Nëse je pjesëtar i kishës sonë, je lider. Nëse po na dëgjon, ti je lider dhe ke ndikim. Je lider në shtëpi, në punë, mes shokëve, ose merr iniciativa.

Si fillim, do të shikojmë një varg, në fakt gjysmë vargu fare.

1 e Korintasve 13:13 *'Tani, pra, këto tri gjëra mbeten: besimi, shpresa dhe dashuria...'*

Së pari besimi, së dyti shpresa, së treti dashuria – ta them edhe gjysmën tjetër të vargut: *"Por më e madhja nga këto është dashuria."*

Nuk do të ndalem te dashuria sot; një ditë tjetër do të flas përsëri për këtë. As për besimin, edhe pse janë të dyja shumë të rëndësishme, flitet më shumë për këto dy.

Do të flas për shpresën, sepse është një nga të treja që flitet më pak, në fakt. Dhe përderisa është një nga tri më të mëdhatë, do të thotë që është shumë e rëndësishme. Është e nevojshme çdo ditë, sidomos në këto kohëra të reja që po jetojmë.

Kush është armiku i shpresës? Kush e fik shpresën? Në fjalë të thjeshta, kush ia ha kokën shpresës? Ta them?

ZHGËNJIMI

Për të qenë plot shpresë, duhet të shohim zhgënjimin së pari, dhe të kuptojmë se si ta heqim atë, sepse kur zhgënjimi ulet këmbëkryq në jetën tonë, shpresa ia fut vrapit.

Tani, le të shikojmë disa parime që na largojnë nga zhgënjimi dhe na mbushin plot shpresë.

Së pari: Çdo person që gjen në Bibël ka kaluar përmes zhgënjimit.

Po ti, a ke pasur momente zhgënjimi?

Mosiu pati momente zhgënjimi nga njerëzit që po drejtonte.

Prindërit e kuptojnë më mirë këtë: A të ka ndodhur ndonjëherë, a të kanë thënë fëmijët, "*Faleminderit që më qortove, sepse ajo që më the më ndihmoi të forcohem më shumë*"? Me shumë gjasa jo.

Marku u zhgënjye nga Pali, një drejtues shumë i madh. A je zhgënjyer ndonjëherë nga një drejtues? Kush e di se sa persona mund të jenë zhgënjyer nga unë.

Nehemia u zhgënjye nga rrethanat në të cilat ndodhej populli në Jeruzalem.

Pjetri u zhgënjye nga vetja e tij, sepse mohoi tre herë se e njihnte Jezusin.

Jezusi u zhgënjye nga njerëzit që e ndiqnin. Ai iu fliste, por ata, njëherë që nuk morën atë që prisnin, ikën. Jezusi iu tha edhe dishepujve, "A doni të ikni edhe ju? A jeni të zhgënjyer edhe ju nga unë? Ikni edhe ju, nëse dëshironi."

Jozefi u zhgënjye nga familja. Sa nga ju e keni kaluar këtë përvojë, zhgënjim nga familja?

Elia u zhgënjye nga kritikantët. Elia ishte një nga profetët më të mëdhenj në Dhjatën e Vjetër. Ai luftoi me 400 profetë të Baalit dhe nuk pati frikë. Por, kur e kritikoi vetëm një grua, iku me vrap dhe u fsheh në një shpellë.

Dhe shumë e shumë të tjerë. Puna është si të dalësh nga zhgënjimi, sepse qenka një pjesë normale e jetës. Dhe ka shumë momente që mund të zhgënjehesh.

Së dyti: Zhgënjimi është i fuqishëm.

Shiko, zhgënjimi është një sëmundje e përgjithshme. Të gjithë e hasin. Për më tepër, përsëritet herë pas here; nuk ndodh vetëm një herë. Gjithashtu, është edhe ngjitës si një virus. Nëse rri me njerëz të zhgënjyer, ata ta ngjisin edhe ty. A mund ta dallosh kur dikush është i zhgënjyer? Po. Nëse pi kafe me të, si do të ikësh nga kafeja, i inkurajuar apo i zhgënjyer? I zhgënjyer, sepse të ka ngjitur edhe ty. Qenka shumë ngjitës, madje edhe nëse përdor maskë dhe lan duart, përsëri mund të të ngjitet.

Përveç kësaj, është shumë dëmtues. Zhgënjimi të dëmton jetën dhe miqësitë.

Dëgjo këtë: Çdo gjë që është dëmtuar tek ti ka filluar së pari me zhgënjimin.

Çdo martesë e dëmtuar ka ndodhur sepse së pari një partner është shumë i zhgënjyer. Asnjë në çift nuk thotë, "*Sa shumë e dua gruan time, ngordh për të, prandaj do divorcohem këtë javë.*" Jo, divorci ndodh sepse niveli i zhgënjimit ka arritur majat. Çdo njeri që largohet nga Perëndia ka ndodhur sepse diçka e ka zhgënjyer. Çdo njeri që lë shkollën apo punën ka ndodhur sepse ka diçka që e ka

zhgënjyer. Zhgënjimi është shumë dëmtues.

Kështu që pyetja e madhe ngelet:

A ka ndonjë mënyrë sesi ta zëvendësojmë zhgënjimin me shpresë?

Shembulli më i mirë për këtë është Nehemia. Le të shikojmë shkurtimisht disa parime nga Nehemia si e zëvendësoi ai zhgënjimin me shpresë.

Ja, të jap një kontekst të shkurtër për ata që nuk e njohin historinë:

Moisiu e nxorri Izraelin nga Egjipti rreth viteve 1400 para Krishtit. Por Izraeli u stabilizua si komb së pari nën mbretërimin e Davidit rreth vitit 1000 para Krishtit. Pas disa brezash mbretërisht, Izraeli u nda në dy pjesë: Mbreteria e Veriut me 10 vise, krahina, qarqe, dhe Mbreteria e Jugut me 2 vise, qarqe. Mbreteria e Jugut quhej Judea dhe kishte kryeqytet Jeruzalemin.

Në vitin 606 para Krishtit, Nebukadnetsari vjen nga Babilonia dhe pushton Jeruzalemin. Pas pushtimit, ai shkatërron muret rrethuese, tempullin dhe çdo gjë tjetër, dhe merr në mërgim gati të gjithë banorët. Sa vjet qëndruan ata në mërgim? Plot 70 vjet. Shumë kohë. Në fund të këtyre 70 viteve, Babilonasit u thanë: "Faleminderit që qëndruat, tani mund të ktheheni në shtëpi. Nuk kemi më inat me ju. Ikni nëse dëshironi." Filluan të ktheheshin grupe-grupe, në fakt u kthyen në tre grupe. Grupi i parë u kthye nën drejtimin e Zerubabelit. Grupi i parë filloi të rindërtonte muret, por nuk ia dolën. Bënë disa punë, por shumë pak, dhe e lanë për gjysmë.

Rreth 50-60 vite më vonë erdhi grupi i dytë me drejtues Ezran. Edhe ata nuk bënë ndonjë punë të madhe, por bënë disa përpjekje. Rindërtuan tempullin, por ai ishte shumë larg tempullit origjinal.

Tani, grupi i tretë vjen me Nehemian pas 92 vitesh. 92 vite zhgënjimesh, frike, pasigurie. Nehemia, së pari, pyet vëllezërit, si është gjendja në Jeruzalem? Ata i thonë troç: Jeruzalemi është për turp, është për faqe të zezë. Kur Nehemia shkon atje, nuk e minimizon problemin. Nuk thotë, "Hajde, mo çuna, s'ka gjë. Jeni mësuar të jetoni kështu, copë-copë. Hajde, të pimë një birrë dhe shohim si është gjendja."

Jo, jo. Ja si thotë:

Nehemia 2:17a *'Atëherë u thashë atyre: "Ju e shikoni gjendjen e mjeruar në të cilat ndodhemi: Jeruzalemi është shkatërruar dhe portat e tij janë konsumuar nga zjarri!... '*

Ai nuk e zvogëlon situatën, zhgënjimin ku ndodhen POR as nuk e lë aty, ja si vazhdon vargu:

Nehemia 2:17b *'Ejani, t'i rindërtojme muret e Jeruzalemit, dhe kështu nuk do të jemi më të turpëruar!'*

Shumë prej jush e dinë vazhdimin e historisë. Nehemia shkoi atje dhe i dha drejtim. Erdhi dikush plot shpresë dhe në sa ditë u ndërtua muri që kishte qenë i shembur për 92 vjet? U rindërtua për 52 ditë. Si ndodhi kjo? Kush e bëri ndryshimin? Erdhi vetëm një person që ishte plot shpresë dhe i nxori të gjithë të tjerët nga moçali i zhgënjimit.

Pyetja është: *Si mund të dalësh nga zhgënjimi dhe të jesh plot shpresë?* Shiko, le të jemi me aq shpresë sa të ndikojmë edhe tek të tjerët rreth e qark dhe ata të shikojnë jetën dhe situatën me tjetër sy. Të shikosh jetën, martesën, punën, familjen, çdo gjë me sy të rinj, që të rindërtohet dhe përmirësohet çdo gjë, sepse ti je plot shpresë dhe po i jep edhe të tjerëve shumë shpresë.

Nga jeta e Nehemias, këto janë katër gjëra që ai bëri dhe që mund të të mbushin me shpresë nëse i aplikon në jetën tënde. Ja e para:

Forcohem frymërisht

Ky është fillimi, A-ja e muhabetit. Nëse do të dalësh nga moçali i zhgënjimit, duhet të kesh bateritë e karikuara frymërisht. Ky është fillimi sesi të dalësh nga zhgënjimi, stresi, frika. Pa Perëndinë është e pamundur të dalësh nga ky lloj moçali.

Ideja e përgjithshme është që ti e kërkon Zotin kur je në hall të madh. Por nevoja për Perëndinë është çdo ditë.

(shembull: Para shumë vitesh, në një takim të rinjsh në një fshat, kishim një moment ku po fliste secili, dhe pyetja ishte si i ishte përgjigjur Perëndia lutjeve tuaja. Një vajzë tha: “Na coi babi të pastronim një arë. Isha me motrën dhe mamin dhe po përtonim shumë. Ndihehim të zhgënjyer sepse donim të shikonim televizor, ndërsa babi na kërkoi të punonim. Por u lutëm bashkë dhe e mbaruam arën shumë shpejt, dhe ishim shumë të gëzuara edhe pasi mbaroi puna.”

“Çfarë, -tha njëri, -ju u lutët për këtë gjë?”)

Duket sikur ideja e lutjes dhe kohës me Zotin është kur ke një gjë shumë të madhe, kur je në pikën e fundit. Por nevoja jonë për të qenë të lidhur me Perëndinë është çdo ditë dhe për çdo gjë, për gjëra të vogla dhe gjëra të mëdha.

Nehemia te kapitulli 1 është shumë i zhgënjyer por nuk e lë me aq.

Nehemia 1:4 *'Sa i dëgjova këto fjalë, u ula dhe qava; pastaj mbajta zi disa ditë me radhë, agjërova dhe u luta përpara Perëndisë të qiellit.'*

Ai nuk tha, "Isha i zhgënjyer, u trishtova, pastaj shkova te lokali i lagjes dhe u bëra tapë për të mbytur hallet." Ose, "Shkova te cepi i pallatit dhe piva tre cigare hashash sa u bëra dru dhe s' dija ku e kisha shtëpinë." Ose, "U trishtova aq shumë sa shkova dhe u zura me gruan dhe tmerrova kalamajtë dhe gjithë pallatin." Jo, nuk thotë ashtu. Çfarë thotë? "U luta." Sytë i ktheu te Perëndia.

Ja si vazhdon më poshtë:

Nehemia 1:5 *'Dhe thashë: "Të lutem shumë, o Zot, Perëndia i qiellit, Perëndi i madh dhe i tmerrshëm, që i qëndron besnik besëlidhjes dhe ke mëshirë për ata që të duan dhe respektojnë urdhërimet e tua,'*

Sytë e Nehemias largohen nga rrethanat zhgënjyese dhe drejtohen te Perëndia. Atje fillon dhe merr zgjidhje situata.

Po lexoja një gjë të bukur për vajzën e Walt Disney, Diana. Ajo e shkroi biografinë e të atit. Ato që sot janë Disney Studio Film dhe Disneyland filluan nga ky njeri, Micky Mouse (Miki Maus) dhe shumë karaktere filmash vizatimorë. Ai ishte vizionar i madh dhe shumë i zoti. Ai ka atë thënien: "If you can dream it, you can do it." Nëse mund ta ëndërrosh, mund ta realizosh.

Por vajza e tij, Diana, thoshte se babai im ishte një baba normal kur ishte në shtëpi. "Kur vija nga shkolla, bënim detyrat bashkë. Më çonte në shkollë çdo ditë. Ishte një baba normal."

Ajo tha: "Kur isha 5 vjeç në kopësht, nuk e kisha idenë fare se kush ishte babai im për të tjerët. Dhe aty e mësova. Ishim në kopësht dhe u ulëm në formë rrethore, dhe të gjithë po thoshim emrat. Kur erdhi radha ime, unë thashë: 'Unë quhem Diana Disney.' Dhe i gjithë grupi u entuziazmua. Mësuesja i qetësoi dhe unë u tremba, mendova se thashë gabim. Por mësuesja më tha: 'Jo, nuk the gjë gabim, po ma thuaj edhe një herë, si e kishe emrin?'

Dhe unë i thashë: "Unë quhem Diana Disney." Dhe grupi përsëri u entuziazmua. Unë shikoja e habitur se çfarë kishte ndodhur. Mësuesja më pyeti përsëri: "Po babai yt si e ka emrin?"

Unë i thashë: "Babi im quhet Walt Disney." Dhe grupi u entuziazmua edhe më shumë. Unë i shikoja e habitur.

Mësuesja më tha: "Shiko, këta gëzohen shumë sepse babai yt është ai që ka bërë Micky Mouse, Disneyland dhe të gjitha këto gjëra të bukura për fëmijët. Janë bërë për shkak të babait tënd." Por unë nuk e kisha idenë, tha ajo.

Kur shkova në shtëpi atë ditë, babai ishte ulur në karrige dhe po lexonte gazetën. Shkova drejt tij, ia hoqa gazetën nga dora dhe i vura duart në mes dhe i thashë: "Babi, pse nuk më ke treguar ti mua që ti je Walt Disney?"

Dhe mu desh një muaj ta merrja veten nga fakti se kush ishte babai im dhe që ishte kaq i zoti."

A nuk duhet të jetë qëndrimi ynë si ky i vajzës së vogël 5-vjeçare? Të mos lejojmë që zhgënjimet, streset dhe pasiguritë të na ndalin dhe të harrojmë kush është Ati ynë. Nehemia nuk i kishte sytë tek zhgënjimi; ai i përqëndronte sytë dhe i fokusonte tek Ati.

Kjo është e veçanta e festimeve që ofron kisha jonë, na ndihmon të kalojmë përtej tensioneve dhe problemeve të jetës. Synimi i festimeve është që të ngremë kokën lart dhe të kujtojmë kush është Ati ynë. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme të kalojmë kohë me Perëndinë duke lexuar Fjalën dhe duke u lutur, për të ngritur sytë lart dhe për të parë se kush është Ati ynë.

Si mund të mbushemi me shpresë? Cila ishte e para? Forcohem frymërisht. Cila është e dyta?

Mbështetem te Perëndia

Një nga mënyrat sesi mbështetesh te Perëndia është kur e degjon atë që të thotë Ai dhe ti ngrihesh dhe e bën. DHE kur ngrihesh për të bërë atë që të ka thënë Perëndia, ka shumë mundësi të hasësh kundërshtime.

Kjo mund të duket e pa-logjikshme: "Po bëj atë që më kërkoi Perëndia, si mund të has ndonjë kundërshtim?" Ka shumë gjasa që e ke përjetuar këtë, madje edhe kur shërben, has kundërshtime. Nehemia hasi kundërshtime duke bërë atë që i kërkoi Perëndia.

Nehemia 2:19 *'Por kur Sanbalati, horoniti dhe Tobiahu, shërbëtorit Amonit, dhe Geshemi, arabi, e mësuan këtë gjë, filluan të tallen dhe të na përbuzin, duke thënë: "Çfarë po bëni? Mos doni, vallë, të ngrini krye kundër mbretit?".'*

Po Nehemia, çfarë iu tha? A tha ai: "Na falni, çuna, është faji ynë, mos u mërzisni, po ikim, mos e ngrini zërin, e kuptuam, po e lëmë punën që na ka kërkuar Perëndia, po ikim. Bye bye, puç puç."?

Jo...

Nehemia 2:20a *'Atëherë unë u përgjigja dhe u thashë atyre: "Do të jetë vetë Perëndia i qiellit që do të na sigurojë suksesin. Ne, shërbëtorët e tij, do të fillojmë ndërtimin...'*

Kush do na e japë suksesin? Perëndia i qiellit. Ne jemi shërbëtorët e Tij që po bëjmë këtë punë. Kjo është një deklaratë e mrekullueshme. Ne i takojmë Atij dhe po bëjmë punën e Tij, dhe do ta vazhdojmë këtë punë.

Sa do të doja të kisha besimin që ka Nehemia në fillimet e mia në shërbesë. Nëse sapo ke filluar të bësh diçka që Perëndia të ka thënë, më dëgjo mua: printoje këtë varg ose shkruaje me dorë dhe vendose diku ku e shikon shpesh, si te pasqyra e banjës, ta lexosh çdo mëngjes, ose te dera e frigoriferit. "Perëndia i qiellit do të më sigurojë suksesin. Unë jam shërbëtor i Tij."

A do të ishte motivuese të nisje ditën kështu?

E sigurt është që Perëndia po të sfidon për të bërë diçka ose për të vazhduar atë që po bën. Po të kërkon të ndryshosh diçka, po të kërkon të japësh diçka, dhe ke merak për të filluar ose për të dhënë ose për të shërbyer.

Shiko, se mund të jesh në hapat e parë të diçkaje shumë të madhe dhe të bukur. Prandaj, mos ngurro; nuk do të ndodhë nëse nuk e fillon.

Siç tha Nehemia në kapitullin 2, vargu 20: "Ne do ta fillojmë punën." Prandaj, përvishi mëngët dhe merre përsipër familjen, martesën, punën, shërbesën, shkollën. Rifilloje punën, rifilloje dhënien e të dhjetës dhe ofertave, rifilloje grupin e vogël, kthehu te ajo që të sfidon Perëndia dhe shiko sesi do të të japë sukses Perëndia vetë.

Cila është e fundit...

Mos u Dorëzo

Kjo është e bukur. Në një moment, grupi që po ndërtonte murin me Nehemian e ndaloi punën dhe u zhgënjye shumë. Atëherë, Nehemia i nxiti me këto fjalë:

Nehemia 4:14 *'Mbasi e shqyrtova situatën u ngrita dhe u thashë parisë, gjyqtarëve dhe pjesës tjetër të popullit: "Mos kini frikë nga ata! Kujtoni Zotin e madh dhe të tmerrshëm dhe luftoni për vëllezërit tuaj, për bijtë dhe bijat tuaja, për bashkëshortet tuaja dhe për shtëpitë tuaja!'"*

Lufto për gjërat që ia vlen të luftosh. Lufto për familjen, për ëndrrën tënde, për gjërat që i ke të çmuara. Mos ki frikë, mos u dorëzo prej të tjerëve; kujto pse ia vlen të luftosh.

E bukura e kësaj historie është se si zhgënjimi kthehet në shpresë. Ata kishin kaluar 92 vjet në zhgënjim, dekurajim, frikë dhe pasiguri. Dhe Nehemia nuk u thotë, "Po s'ka gjë, e kanë provuar edhe të tjerë para nesh dhe nuk iu ka ecur; as neve nuk na ecën. Ta lëmë në mes." Ai thotë, "Jo, mos u dorëzoni, mos u tërhiqni; luftoni për hir të asaj që e keni të çmuar."

Si është situata që po kalon këto kohë? Ndonjëri mund të thotë: "Ky vit ka qenë më i vështirë se çdo vit tjetër; nuk di nëse do e marr veten. Nuk di nëse ka shpresë për familjen time, për punën time, për shkollën time, për ëndrrën time, për lidhjen time. Nuk di nëse do e marrin veten fëmijët e mi. Nuk di nëse do e marr veten kisha nga kjo situatë. Nuk di nëse do e marr veten unë nga kjo, nga ajo, nga ajo."

Një film tregon një histori shumë të bukur. Është mbi Winston Churchill, kryeministrin e Anglisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjermania e kishte rrethuar pothuajse për ta pushtuar, dhe shumë drejtues e nxisnin të dorëzohej. Por një ditë, ai hipën në metro dhe njerëzit u habitën sesi udhëtonte kryeministri me ta.

Ai i pyeti njerëzit, "Nëse do kishit një vështirësi të madhe në familje ose në punë, a do të dorëzoheshit?" Njerëzit i thanë se kurrë nuk do të dorëzoheshin. Një vajzë e vogël tha, me një qëndrim serioz, "Kurrë, kurrë, kurrë nuk do të dorëzohesha."

Churchill zbriti, mblodhi drejtuesit e partisë, iu foli atyre dhe më pas i foli parlamentit. Cili ishte mesazhi i tij? "Ne kurrë nuk do të dorëzohemi." Ata luftuan fort, dhe Gjermania nuk arriti ta pushtonte Anglinë.

Si Nehemia, Churchill nuk u dorëzua kurrë dhe arriti të shpëtojë vendin e tij.

Nëse Jezusi do të thoshte një fjalë për ty sot, ka shumë gjasa që do të thoshte:

"Nuk ka rëndësi nëse jeta ka ngecur për disa javë, ose nëse ti vetë ke ngecur; nuk ka rëndësi sesi ishe dje apo para një viti. Ajo që ka rëndësi është sot. Sot, ngrihu dhe shkëlqej, sot ngrihu dhe mbushu plot shpresë. Sepse nuk ka mbaruar akoma. Unë jam me ty. Dhe kur e di se kush është Ati yt, nuk ke arsye të zhgënjehesh, të dorëzohesh, të frikësosh ose të shqetësohesh."

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.